



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UDHËZUES PËR APLIKANTËT –NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE NË KUADËR TË THIRRJES PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) krijuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të Ligjit nr.75/ 2019 “Për rininë”, VKM nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” duke u bazuar në VKM nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore, organizatave për të rinjtë që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, financon projektet e propozuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë këshilla të qarta dhe koncize për të gjitha NJVV-të e interesuara në procesin e dorëzimit të projekt-propozimeve në kuadër të Thirrjes Publike për financim.

1. SYNIMI I PËRGJITHSHËM I THIRRJES PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME DHE PËRPARËSITË

Fondet do t’u ndahen Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore projektet e të cilave lidhen vetëm me financimin e investimeve kapitale në infrastrukturë dhe pajisje të lidhura me rikonstruksionin, ndërtimin, rindërtimin dhe funksionimin e objekteve publike, pjesë e infrastrukturës rinore si: qendrat rinore, bibliotekat, qendrat rekreative për të rinjtë sikurse përcaktuar në këtë Udhëzues.

2. FONDET (GRANTET) QË JANË NË DISPOZICION PËR PROJEKTE

Vlera e granteve që ndahet si pjesë e kësaj thirrje publike është 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë.

Shuma e financimit për projektpropozimin e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore nga AKR-ja është 10.000.000 lekë.

Njësia e Vetëqeverisjes Vendore duhet të bashkëfinancojë projektpropozimin me të paktën 10% të shumës së financimit të kërkuar nga AKR-ja.

Totali i grantit për këtë Thirrje është: 50.000.000 Lekë.

3. KUSH MUND TË APLIKOJË

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur dhe e barabartë për të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë.

NJVV-të mund të kërkojnë të përfitojnë mbështetje financiare pas plotësimit të kriterëve të mëposhtme:

- a) të paraqesin projektpropozimin me objekt zhvillimin e infrastrukturës rinore;
- b) të paraqesin shprehjen e interesit të miratuar nga kryetari i bashkisë;

Kandidatët do të përjashtohen nga pjesëmarrja në thirrje apo nga ndarja e granteve nëse në kohën e dorëzimit të projekt propozimeve:

- nuk kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme sipas seksionit 7 dhe 8 të këtij udhëzuesi;
- buxheti nuk është në vlerën e kërkuar;
- kohëzgjatja e propozuar e projektit është më e shkurtër se 6 muaj ose më e gjatë se 12 muaj;

4. KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e projekt – propozimit mund të jetë nga 6 deri në 12 muaj.

5. VENDI I ZBATIMIT

Projektet duhet të zbatohen ekskluzivisht në territorin e bashkisë që po aplikon për grant.

6. LLOJET E PROJEKTEVE

- Projekt-propozimet që do të financohen nga AKR duhet të jenë të përgatitura në përputhje me thirrjen publike duke kërkuar financimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të objekteve publike dhe të infrastrukturës rinore sipas pikës 1, të këtij udhëzuesi.

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR TË APLIKUAR

I. Dokumentet kryesore:

- Projekt propozimi (në formatin Ëord - Shtojca 7);
- Preventivi/Plani i ndërtimit, rindërtimit, rikonstruksionit dhe funksionimit të objekteve publike të infrastrukturës rinore,
- Buxheti i projektpropozimit (format Excel-Shtojca 8);
- Shprehje e interesit e miratuar nga kryetari i bashkisë;
- Plani i aktiviteteve dhe dukshmërisë (formati Ëord- Shtojca 10);

Shënim: Me qëllim vlerësimin e projekt – propozimit, dokumentacioni kryesor duhet të dorëzohet në 3 kopje fizike dhe 1 elektronike (USB) është i detyrueshëm.

8. KUR DHE KU TË MERRET DHE TË DORËZOHET PAKETA E APLIKIMIT

Informacioni përkatës si dhe një version elektronik i të gjithë paketës së aplikimit mund të merret nga faqja e internetit: ëëë.rinia.gov.al

Aplikimet e plotësuara me të gjithë dokumentacionin, duhet të dorëzohen **në tre (3) kopje fizike dhe në një kopje elektronike (në USB)** përmes postës zyrtare apo personalisht, të vendosura në një zarf të vulosur që i referohet thirrjes publike, gjatë orarit zyrtar të punës, në adresën:

Agjencia Kombëtare e Rinisë,
Rruga “Naim Frashëri”
Tiranë, Shqipëri

Afati për dorëzimin e aplikimeve është data **20.09.2022, ora 16:30**. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të jenë shkruar **emri i thirrjes publike për projekt-propozime, emri i plotë dhe adresa e aplikantit, emri i plotë i projektit** dhe fjalët: **“Të mos hapet përpara hapjes zyrtare”**. Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (p.sh. me faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresa tjera nuk do të merren parasysh. AKR do të protokollojë çdo aplikim të marrë në dorëzim dhe do të lëshojë vërtetimin përkatës (datën dhe orën e pranimit të projekt-propozimit). Të gjithë aplikantët që kanë paraqitur propozime, pavarësisht nëse pranohen ose jo, njoftohen me shkrim për vendimin e marrë për projekt-propozimin e tyre brenda **45 ditëve** kalendarike nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet do të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

9. INFORMACION TJETËR

Me qëllim mbështetjen e NJVV-ve për të paraqitur aplikime në përputhje me kriteret e Udhëzuesit, Agjencia Kombëtare e Rinisë do të organizojë takime informuese/ ditë të hapura gjatë shkrimit të projekt - propozimit. Më konkretisht:

Sesionet informuese (ditët e hapura për më shumë informacion):

Lidhur me këtë thirrje, për NJVV-të e interesuara për të aplikuar në këtë thirrje, sesioni informues i parë, do të mbahet në datën 08.09.2022, ora 12:00 – 12:45 online. Në vijim do të caktohet data për sesionin e radhës (nëse është e nevojshme).

Pyetje rreth kësaj thirrje mund të bëhen përmes adresës: info@rinia.gov.al, duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dërgohen deri më **13.09.2022**, ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data e pranimit të pyetjeve përkatëse.

Për qëllime transparence, përgjigjet do t’u dërgohen gjithashtu të gjithë aplikantëve të mundshëm, ose do të botohen në faqen e internetit të AKR-së.

10. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PROJEKTPROPOZIMEVE

Projektpropozimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit, i cili përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Ministri përgjegjës për rininë, të përzgjedhur si vijon: a) dy anëtarë të caktuar nga Ministri përgjegjës për rininë, ku njëri luan rolin e kryetarit të komisionit; b) një anëtar i caktuar nga titullari i AKR-së; c) dy anëtarë ekspertë nga shoqëria civile me ekspertizë në vlerësimin e projekteve zhvillimore dhe me ndikim tek të rinjtë¹.

Projekt propozimet me pikët më të larta, do të propozohen për miratim Ministrin përgjegjës për rininë.

Projektpropozimet do të vlerësohen në bazë të:

(i) *Kritereve administrative:*

- Aplikimi është dorëzuar brenda afatit, specifikuar në seksionin Nr. 8 të këtij Udhëzuesi;
- Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të seksionit Nr. 8;
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (USB).

(ii) *Kritereve të përmbajtjes/vlerësimi i cilësisë së projektit dhe vlerësimi financiar:*

Vlerësimi i cilësisë së projektit, përfshirë edhe buxhetin e propozuar, do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuar në Tabelën Vlerësuese që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

Sistemi i vlerësimit është si më poshtë:

Kriteret e vlerësimit ndahen në seksione dhe nën-seksione: **Secili nën-seksion duhet të vlerësohet me pikët e caktuara nga 1 në 5, në këtë mënyrë: 1= shumë keq; 2= keq; 3= pranueshëm; 4= mirë; 5= shumë mirë.** Secili anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësuese dhe të gjithë anëtarët e nënshkruajnë tabelën vlerësuese përmbledhëse për secilin projekt propozim. Radhitja e projekt propozimeve bëhet në atë mënyrë ku projekt propozimi i radhitur si i pari është ai i cili kundrejt limitit të kërkuar për segment ka fituar numrin më të lartë të pikëve deri tek projekt propozimi me numrin më të ulët të pikëve.

- Pikët maksimale të vlerësimit për një projekt – propozim janë 70;

Vendimi për aprovimin e grantit mbështetet mbi numrin e përgjithshëm të projekteve që mund të financohen me buxhetin në dispozicion. Projektet që kanë fituar numër më të madh të pikëve kundrejt limitit të kërkuar për segment do të kenë prioritet gjatë dhënies së granteve.

Shënim për Seksionin 1/Tabela e Vlerësimit: Relevanca dhe fizibiliteti

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 12 ose më shumë pikë, në seksionin 1. Kjo nënkupton që projekti duhet të jetë relevant për qëllimin e thirrjes publike, të ketë ndikim dhe vlerë të shtuar për një pjesë konsiderueshme të komunitetit rinor të Bashkisë, përfshirë të rejtat, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe në kushte të disavantazhuara, cilësia dhe logjika e projektit

¹ Kur një donator apo grup donatorësh angazhohen të mbështesin thirrjen e AKR-së, ruan të drejtën e propozimit të një anëtari në përbërje të komisionit. Në këtë rast, komisioni do të përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë..

duhet të jetë e përshtatshme dhe ndërhyrja e propozuar standardin e hapsirave fizike dhe infrastrukturore miqsore për të rinjtë, të hapura, të sigurta dhe të aksesueshme nga të gjithë.

Shënim për Seksionin 2/Tabela e Vlerësimit: Qëndrueshmëria

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 6 ose më shumë pikë, në seksionin 2. Kjo sepse pikët tregojnë se aplikanti nuk ka parashikuar në mënyrë të përshtatshme apo është angazhuar institucionalisht për të përdorur infrastrukturën rinore të ndërtuar në mbështetje të ndikimit afatgjatë dhe të shumëfishhtë për komunitetin rinor dhe bashkitë e zonës.

Qëndrueshmëria e projektpropozimit mbështetet në përshtatshmërinë e ndëryhyrjes në infrastrukturën rinore dhe në parashikimin e aktiviteteve dhe mekanizmave që sigurojnë ndikimin e saj afatgjatë dhe të shumëfishhtë tek komunitetin rinor të Bashkisë.

Shënim për Seksionin 3/Tabela e Vlerësimit: Buxheti dhe efikasiteti i kostove

Kjo nënkupton që Bashkia ka parashikuar një buxhet të përshtatshëm dhe koherent për realizimin e ndërhyrjes së projektit, si dhe ka vënë në dispozicion fondet e përshtatshme për të siguruar realizimin dhe vijueshmërinë e aktiviteteve të projektit.

Projekti përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve në Seksionin 3 është më i ulët se 7 pikë.

Tabela e vlerësimit

Seksioni	Pikët maksimale	Pikët mesatare
1. Relevanca dhe fizibiliteti	35	
1.1 Sa relevant është projektpropozimi krahasuar me synimin përcaktuar në thirrjen publike?	5	
1.2 A është ndërhyrja e propozuar e parashikuar në dokumentet e miratuara për zhvillimin strategjik të Bashkisë?	5	
1.3 A është ndërhyrja e propozuar me ndikim për një pjesë të qënësishme të popullsisë rinore të bashkisë? - Nëse ndërhyrja është me përfitim për mbi 40% të popullsisë rinore të Bashkisë = 5 pikë. - Nëse ndërhyrja është me përfitim për 30% - 40% të popullsisë rinore të Bashkisë = 4 pikë. - Nëse ndërhyrja është me përfitim për 20% - 30% të popullsisë rinore të Bashkisë = 3 pikë. - Nëse ndërhyrja është me përfitim për 10% - 20% të popullsisë rinore të Bashkisë = 2 pikë. - Nëse ndërhyrja është me përfitim për 5% - 10% të popullsisë rinore të Bashkisë = 1 pikë - Nëse ndërhyrja është me përfitim për nën 5% të popullsisë rinore të Bashkisë = 0 pikë	5	
1.4 A prodhon projektpropozimi vlerë të shtuar ndaj komunitetit rinor të bashkisë? <i>Vlerësim maksimal marrin projektpropozimet të cilat krijojnë sinergji me iniciativa/programe ekzistuese për rininë dhe mbështesin realizimin e prioritetëve strategjike për rininë si aktivizimi dhe fuqizimi i të rinjve, mbështetja e novacionit rinor dhe punësimit të të rinjve dhe mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e tyre.</i>	5	
1.5 A bën projektpropozimi advokim për një qasje të bazuar tek të drejtat dhe a ka ndikim pozitiv tek grupet e pafavorizuara? (Promovimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të rejave, mbështetja e të rinjve në kushte vulnerabiliteti dhe të rinjve me aftësi të kufizuara etj.). <i>Vlerësim maksimal marrin projektpropozimet, të cilat ndikojnë në të paktën 2 grupe të pafavorizuara</i>	5	
1.6 A është logjika e projektpropozimit e qartë dhe e realizueshme? A është parashikuar saktë komponenti i dukshmërisë?	5	
1.7 Sa e respekton ndërhyrja e propozuar standardin e hapësirave fizike dhe infrastrukturore miqsore për të rinjtë, të hapura, të sigurta dhe të aksesueshme nga të gjithë.	5	

2. Qëndrueshmëria	15	
2.1 A do të ketë projektpropozimi ndikime të shumëfishta? (përfshirë mundësinë e zbatimit nga grupe të tjera të komunitetit vendor dhe/ose shtrirjen e ndikimit tek veprimtari të tjera të komunitetit rinor)	5	
2.2 A janë rezultatet e pritshme të projektpropozimit të qëndrueshme nga ana institucionale? (a ka parashtruar bashkia mekanizmat që sigurojnë qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit dhe ndikimin e tyre shumëvjeçar mbi komunitetin rinor të synuar? A do institucionalizohen këto mekanizma?)	5	
2.3 A ka mundësi që rezultatet/arritjet e pritshme afatgjata do të ndikojnë në kushtet ekonomike dhe/ose cilësinë e jetës në bashkinë tuaj?	5	
3. Buxheti dhe efikasiteti i kostove	20	
3.1 A është i kënaqshëm raporti ndërmjet shpenzimeve të parashikuara dhe rezultateve të pritshme?	5	
3.2 A është kostoja e sugjeruar e nevojshme për zbatimin e projektit?	5	
3.3 Detajimi i buxhetit a është buxheti i qartë dhe a përfshin edhe pjesën përshkruese? (përfshirë shpjegimet për bashkefinancimin e bashkise)	5	
3.4 A do të bashkefinancojë Bashkia në zbatimin e ndërhyrjes? Mbi 30 % të vlerës së projektit – 5 pike 20-30 % të vlerës së projektit – 3 pike 10-20 % të vlerës së projektit – 2 pike 10% të vlerës së projektit – 1 pike	5	
Pikët totale maksimale	70	

Njoftimi rreth vendimmarrjes

Komisioni shqyrton e vlerëson çdo projektpropozim të dorëzuar në thirrjen konkurruese të AKR-së, bazuar në kriteret, procedurat, dokumentacionin dhe afatet e thirrjes publike, të përcaktuara në këtë Udhëzues, në Ligjin Nr. 75/2019 “Për Rininë” si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 566/2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore, organizatave për të rinjtë që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”. Komisioni në përfundim të vendimmarrjes, harton procesverbalin i cili përmban renditjen e projektpropozimeve të shqyrtuara bazuar në pikëzimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, vendimmarrjen e arsyetuar për çdo projektpropozim, rekomandimet për rishikim të një projektpropozimi të përzgjedhur me kusht për financim dhe informacionin për projektet e skualifikuara për mungesë dokumentacioni. NJVV-ve mund t’i kërkohej modifikime të caktuara në projekt për ta harmonizuar atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit. Më konkretisht, kur projekt-propozimi është përzgjedhur me kusht, AKR-ja i kërkon kandidatit miratimin e tij, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, për reflektimin e rekomandimeve të Komisionit të Vlerësimit për rishikimin e projekt-propozimit. Kandidati që nuk shprehet brenda këtij afati apo refuzon të rishikojë projekt-propozimin bazuar në këto rekomandime, skualifikohet dhe humb të drejtën e mbështetjes me fondet grant për rininë. Në këtë rast, AKR-ja njofton kandidatin pasardhës në listë dhe e fton në procesin e negocimit në përputhje me parashikimet e nenit 17 të VKM Nr. 566/2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore, organizatave për të rinjtë që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”.

Në çdo rast, nëse projekt-propozimet e tyre miratohen për financim apo jo, të gjithë aplikantëve iu njoftohet me shkrim vendimi për projekt-propozimin e tyre brenda 45 ditë kalendarike nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet shpallen në faqen e internetit ëëë.rinia.gov.al.

Vendimi për refuzimin e projektpropozimit apo për mosdhënie fondesh merret nëse:

- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore nuk i përmbushin kushtet e thirrjes publike;

- Projektpropozimet nuk i përbahen kritereve që duhet të kenë në përmbajtje (psh. tejkalojnë fushë-veprimin e thirrjes publike për projekt propozime, kohëzgjatja e parashikuar e projektit tejkalon kohën maksimale të lejuar;
- Projektpropozimi nuk kërkon financim për rikonstruksionin, ndërtimin, rindërtimin dhe funksionimin e objekteve publike dhe të infrastrukturës rinore;
- Cilësia e projektpropozimit ka qenë teknikisht dhe financiarisht më e ulët në krahasim me projektet e përzgjedhura për financim.

AKR-ja njofton kandidatin të përzgjedhur jo fitues mbi rezultatin e vlerësimit, hapat për të kërkuar arsyetimin e vendimit dhe procedurën e ankimit.

Kushtet rreth zbatimit të projektit pas miratimit të grantit

Agjencia Kombëtare e Rinisë pasi përfundon procedurën e negocimit me çdo kandidat të përzgjedhur për financim, përcjell për miratim pranë ministrit përgjegjës për rininë listën e rishikuar me projektet fituese, përshkrimin e projekteve dhe shumat përfundimtare të granteve për financim.

Pas marrjes së vendimit për miratimin e grantit, nënshkruhet kontrata mes AKR-së dhe NJVV-së ku parashikohen dispozitat për zbatimin e projektit.

Njësisë së vetëqeverisjes vendore u livrohet fondi për projektin në 2 (dy) këste:

- a) kësti i parë: 90 (nëntëdhjetë) % të vlerës së fondit menjëherë pas lidhjes së kontratës së grantit;
- b) kësti i dytë: 10 (dhjetë) % të vlerës së fondit, menjëherë pas miratimit nga AKR-ja të raportit përshkrues e financiar përfundimtar.

Subjekti përfitues raporton pranë AKR-së mbi ecurinë e zbatimit të projektit, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në kontratën e grantit, udhëzuesin për raportimin periodik të progresit dhe dokumentet mbështetëse të raportimit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për rininë. AKR-ja kryen monitorimin e zbatimit të projekteve dhe raporton për mbarëvajtjen e tyre pranë ministrit përgjegjës për rininë.

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 7 Projekt Propozimi

Shtojca 8 Buxheti

Shtojca 10 Plani i Aktiviteteve dhe dukshmërisë